



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollesha", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICION

“Specialist Marketingu”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “**Ekipe Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kandidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Specialist Marketingu**”

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpikë. Projekti do të formojë Ekipe sportive jashtë shkollorë në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e Specialistit të Marketingut

Specialisti Marketing angazhohet gjatë hartimit, përpilimit, dhe zbatimit të planit të marketingut dhe promovimit të Projektit. Angazhohet gjatë hartimit, përpilimit, dhe zbatimit të fushatave promovionale të projektit si dhe kryen komunikim publik në emër të projektit me sponsora potencialë. Për të përmbushur objektivat e caktuara Specialisti i Marketingut duhet të kryejë detyrat si më poshtë:

- Asiston në zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të Komunikimit të Marketingut të projektit.



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

- Kujdeset për çdo aspekt të marketingut tradicional, në media të shkruar dhe atë audio vizive, për materialet promociionale apo broshura që projekti prodhon, si dhe kujdeset që të jenë në linjë me filozofinë e projektit.
- Mat efektivitetin e kanaleve të komunikimit sipas audiencës së targetuar.
- Ruan marrëdhënie bashkëpunimi shumë të mira me departamentet e tjera të projektit.
- Synon përmirësimin dhe rritjen e imazhit të projektit.
- Kontribuon për krijimin e brand/identitetit të projektit.
- Kryen funksione administrative në funksion të marketingut të projektit.

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Minimumi një diplomë Bachelor në Marketing.
- E preferuar një diplomë Master në Marketing ose Biznes.
- Eksperiencë pune minimum 3-5 vjet.
- Njohuri të teknikave të marketingut tradicional.
- Aftësi në zbatimin e aktiviteteve të marketingut.
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze.
- Të ketë aftësi të mira në shkrimin e projekteve mediatike.

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Aftësi ndërpersonale, komunikim profesional verbal dhe të shkruar.
- Aftësi bashkëpunimi dhe ndërveprimi në ekip dhe me drejtuesit.
- Qasje pozitive dhe energjike në punë.
- Orientim ndaj detajeve dhe organizimit të proçeve të punës.





Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollesha", Sheshi Mustafa Q. Ataturk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 04 Maj 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin Specialist Marketingu "Ekipet Sportive 2022"**.

